



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1674/4 prot.

Datë: 16.07.2025

V E N D I M

Nr. 918/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.07.2025 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - mall”, me nr. REF-51815-06-19-2025, me objekt “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 01.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të mësipërme

Ankimues:

Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, me Nipt. L82428011G dhe adresë Rruga “Njësia Administrative nr. 10, Rruga “Fortuzi” , Nr. 66/1, Tiranë

Operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK me Nipt. K71903025A dhe adresë: Rruga “Gjin Bue Shpata”, Godina av. Vjeter, Hyrja 7, Ap. 34, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Portual Durrës.
Lagja Nr. 1, Rruga Tregtare, Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.06.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - mall”, me nr. REF-51815-06-19-2025, me objekt “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 01.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Në datën 25.06.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5480 dhe me nr. 1674/2025 prot., datë 26.06.2025, e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë:

1- *“Kerkese per ndarjen e procedures ne lote*

Autoriteti kontraktor ka perfshire ne te njejten procedure prokurimi, produkte qe nuk i perkasin te njejtës kategori.

Ne listen e produkteve verejme:

- a) *Paisje Hardëare IT - Njesi Qendrore Tip 1 , Monitor 27” , Laptop Advanced, Tablet*
- b) *Paisje Nderlidhjeje në Radio Marese tip1, Radio Marrese Tip2 , Telefon Fiks*
- c) *Platforme Menaxhimi MDM (Softëare)*

Per grupin b) te artikujve (Radio Marese) ne specifikimet teknike, AK ka percaktuar se keto radio duhet te jene te pajtueshme dhe te integrueshme me nje sistem te nje marke te caktuar (ICOM), cka e kufizon akoma dhe me shume numrin e ofertuesve qe tregetojne kete kategori radiosho. Nga shqyrtimi i specifikimeve teknike per keto produkte dalim ne perfundimin qe keto produkte tregetohen vetem nga operatore te licensuar nga AKEP, pasi perdorin frekuenca Civile te njejta me Zjarrefikset, ambulancat etj. Vetem nje numer i kufizuar operatorësh ekonomike do te mund te ofertonte per keto produkte.

Gjithashtu Platforme Menaxhimi MDM (Softëare) eshte nje softëare specifik per paisjet e levizshme (Mobile Device Managment), qe tregetohet nga nje numer shume i kufizuar operatorësh ekonomike. Per me teper, eshte i nje natyre krejt te ndryshme me Paisjet IT Hardëare.

Perfshirja e produkteve b) dhe c) me siper ne te njejten procedure me a) Paisjet IT Hardëare, eshte ne kundërshtim me parimet themelore te Ligjit te Prokurimeve Publike Per sa me siper kerkojme ndarjen e produkteve Paisje Hardëare IT - Njesi Qendrore Tip 1 , Monitor 27” , Laptop Advanced, Tablet ne lot te ndryshem nga produktet e tjere

Ne piken 2.3.3 te shtojces 8 kerkohet:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar për artikujt objekt në këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim

nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi

Kerkesa per autorizim prodhuesi per te gjithë produktet objekt prokurimi, perfshire ato qe zene nje peshe shume te vogel ne totalin e produkteve, nuk eshte ne perputhje me LPP (kerkesë jo proporcionale)

Konkretisht, kerkesa per autorizim prodhuesi per artikullin nr.5 Tablet, qe perben me pak se 3% te totalit te fondit limit, nuk mbeshetet ne LPP pasi nuk eshte kerkesë proporcionale.

Gjithashtu kerkesa per autorizim prodhuesi per artikullin nr.8 Platforme Menaxhimi MDM, i cili eshte vetem 1 cope dhe perben me pak se 5% te fondit limit, nuk mbeshetet ne LPP pasi nuk eshte kerkesë proporcionale

Per sa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses per autorizim prodhuesi per artikujt me peshe shume te vogel ne totalin e procedures, artikujt nr.5 dhe nr.8

2- Modifikimi i pikes 2.3.2 te Shtojces 8

Ne piken 2.3.2 kerkohet:

Operatori Ekonomik duhet te jete i certifikuar si me poshtë. Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesi duhet te paraqesë certifikatën e kërkuar për:

- ISO 9001 : 2015 ose ekuivalente per menaxhimin e cilesise*
- ISO 27001 : 2022 ose ekuivalente per menaxhimin e sigurise se informacionit*

Kerkesa per ISO 27001:2022 nuk perputhet me objektin e kontrates. Kontrata ne fjale ka objekt blerje mallra ndersa ISO i referohet sigurise se informacionit (ne proceduren ne fjale nuk ka shembim informacioni midis AK dhe OE)

Per sa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses per ISO 27001..”.

II.2. Në datën 26.06.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5486 dhe me nr. 1691/2025 prot., datë 27.06.2025, e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë:

“Kompania Optima Communication sh.p.k. me NUIS K71903025A, shpreh interes per te marre pjese ne proceduren e prokurimit me object “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, publikuar ne faqen e APP-se nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durres me date 20.06.2025, dhe parashikuar per tu zhvilluar ne date 01.07.2025.

Ne gjykimin tone, ka kriteret per kualifikim dhe specifikime te vendosura nga AK ne kete procedure qe jane ne shkelje te LPP, prandaj bazuar ne Ligjin e Prokurimit Publik nr. 162 dt. 23.12.2020, i ndryshuar, neni 110, si edhe Rregullat e Prokurimit Publik, neni 94 dhe neni 97, po paraqesim kete ankese.

PIKA 1

Ne Njoftimin e Kontrates, Seksioni 2, si edhe ne shtojcen 7 në Formulari I Sasise dhe Grafikut te Levrimit, eshte kerkuar:

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja do të jetë 10 (dhjetë) ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Afatet e lëvrimit: 10 (dhjetë) ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës

ARGUMENT 1

Afati 10 ditor per levrim eshte jasht mase I shkurter per procedura te tilla, ne kete periudhe te vitit. Ne procedura te ndryshme prokurimi te zhvilluara nga AK te ndryshme, kerkohen lloje nga me te ndryshmet te pajisjeve kompjuterike, dhe eshte e pamundur per nje OE ti mbaje gjendje ne magazine te gjitha llojet e pajisjeve, ne sasite e kerkuara. Patjeter qe OE kane nevoje te furnizohen ne momentin qe shpallen fitues te nje procedure te caktuar. Sjellim ne vemendje qe pajisjet kompjuterike nuk prodhohen ne Shqiperi, jane produkte importi, dhe afati 10 ditor eshte tejet i pamjaftueshem per te bere porosi tek furnitoret e huaj, per te importuar furnizime nga jasht shtetit, per te bere procedurat e detyrueshme te zhdoganimit, magazinimit dhe levrimit te mallit te AK. Mendoni qe brenda ketyre 10 diteve perfshihen se 1-2 fundjava.

Nje tjeter veshtiresi e shtuar eshte fakti qe afati i levrimit perkon me muajin gusht qe sic e dime

eshte muaj pushimet per furnitoret e huaj duke na e bere thujse te pamundur levrimin.

Te tilla afate levrimi jane diskriminuese dhe pengojne konkurencen ne procedura prokurimi, duke mos lejuar ofertimin, sidomos per biznesin e vogel dhe te mesem, pengojne pjesemarrjen e OE dhe nuk jane aspak gjithheperfshirese. Nje tender me afat kaq te shkurter dhe ne nje periudhe kaq te veshtire te vitit per te marre furnizime (per shkak te pushimeve verore), mund te realizohet vetem nga ndonje OE i paracaktuar qe e ka gjendje mallin ne magazine, duke perjashtuar nga prokurimi te gjithhe operatoret e tjere, te cilet mund te ofrojne edhe cmime shume te favorshme per AK, por nuk mund te ofertojne per shkak te pengeses qe vendos nje afat kaq i shkurter i zbatimit.

Sjellim ne vemendje se mallrat qe po prokurohen jane pajisje kompjuterike, pra nuk jane mallra emergjence, perkundrazi jane aktive afatgjata, prandaj nuk ka asnje arsye per afat levrimi te shkurter qe nuk lejon OE te bejne punen e tyre. Lista perbehet nga artikuj te shumellojshem, te cilet vijne nga prodhues te ndryshem, dhe OE kane nevojte per kohen e tyre per te grumbulluar mallrat e kerkuara.

.....Ne kete procedure jane perfshire produkte te tre llojeve te ndryshme: pajisje kompjuterike, pajisje nderlidhje komunikimi, dhe softëare platforme.....

Tre llojet e produkteve nuk kane asnje lidhje me njera tjetren, dhe prodhohen dhe tregetohen nga kompani krejtesisht te vecanta.

Madje per produktet e nderlidhjes jane vendosur nga AK edhe kerkesa shume specifike, duke i bere keto produkte krejtesisht te vecanta, pa asnje lidhje me pajisjet kompjuterike:

Aparatura radio-marrëse duhet të jetë plotësisht e pajtueshme dhe e integrueshme me sistemin e menaxhimit të komunikimit IDAS (Icom Digital Advanced System), duke mbështetur protokollet përkatëse të komunikimit digjital si NXDN? Type-D trunking, në përputhje me kërkesat e sistemit ekzistues IDAS, për të siguruar ndërveprim dhe integrim të plotë mes pajisjeve portative dhe mobile. Për të verifikuar pajtueshmërinë teknike me sistemin IDAS, është e detyrueshme të paraqitet dokumentacioni teknik zyrtar nga prodhuesi, ku të deklarohej qartë përputhshmëria e pajisjes me standardet dhe arkitekturën e komunikimit të IDAS.

Pajisja duhet të jete e pajisur me të gjithë aksesoret e nevojshëm për funksionimin e plotë në këtë sistem, përfshirë, por jo vetëm: antena të përshtatshme për frekuencën përkatëse, furnizim energjie, mikrofoni, dhe çdo kabell apo modul shtesë i kërkuar për integrim dhe aktivizim të funksioneve të sistemit të menaxhimit IDAS.

Lutemi te ndahet procedura ne lote sipas natyrave te produkteve qe kerkohen ne menyre qe te mundesohet ofertimi dhe procedura te jete sa me gjithheperfshirese.

Duke lene bashke tre lloje te ndryshme produktesh pengohen kompanite te ofertojne ne menyre te padrejte.

ARGUMENT 3

Ne kriteret e procedures nuk ka asnje kerkese per paraqitje katalogjesh. Si rrjedhoje behet i pamundur plotesimi i pikave b dhe c, te kriterit 2.3.4:

b) Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.

c) Nr. i faqes në katalog referuar Nr.Idetifikues te artikullit të ofruar sipas listës i shenuar me nje shenje dalluese.

Gjithashtu behet i pamundur edhe plotesimi i tre kolonave te "Ofertes teknike":

EMRI KATALOGUT, PROSPEKTIT

NR.FAQES KATALOGUT, PROSPEKTIT

NR.IDENTIFIKUES I PRODUKTIT

Lutemi te hiqen pikat b) dhe c) nga kriteri 2.3.4 si edhe tre kolonat "EMRI KATALOGUT, PROSPEKTIT, NR.FAQES KATALOGUT, PROSPEKTIT, NR.IDENTIFIKUES I PRODUKTIT", nga "Oferta teknike".

Sjellim ne vemendje se kjo procedure, me te njejtin objekt, eshte zhvilluar nga ky AK edhe ne vitin 2023, edhe ne ate rast ka pasur nje ankese nga nje OE pikerisht per te njejten problematike, ku OE ankimues ka kerkuar:

Duke qene se tek DST Tek DST, Shtojta 7 Formulari i Kriterëve te Perzgjedhjes/Kualifikimit nuk eshte kerkuar paraqitja e katalogeve dhe markimi i tyre, kerkojme modifikimin e pikes 2.3.5 ne: 2.3.5 Operatorët ekonomike ofertues duhet te paraqesin Dokumentin e titulluar "Oferta Teknike", te ngarkuar ne SPE nga Autoriteti Kontraktor ne formen e nje tabele kerkesat e te cilit duhet te plotesohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listes. Oferta teknike duhet te permbaje te dhenat si me poshte:

a) Emri i kompanise prodhuese ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me produktet e te cileve Operatori Ekonomik do te paraqitet ne dokumentat e ofertimit. Adresa dhe eeb-sit te sakta te kompanise prodhuese ose distributorit te autorizuar",

PIKA 4

Ne Kriterete e Vecanta per Kualifikim eshte kerkuar:

GARANCIA E PRODUKTEVE TE FURNIZUARA

Produktet e furnizuara duhet të jenë të reja si dhe të kenë një garanci përdorimi jo më pak se 3 vjet nga marrja e tyre në dorezim.

ARGUMENT 4

Afatet e garancise se produkteve jane te ndryshme ne varesi te produktit, sic e shohim edhe ne specifikimet teknike te procedures. Ne specifikimet teknike te produkteve te procedures afatet e garancise jane percaktuar te ndryshme, disa produkte kane afat 1 vjecar garancie, disa 3 vjecar, ndersa per softëare/platforme nuk ka fare afat garancie.

Lutemi te ndryshohet kriteri i Produktet e furnizuara duhet të jenë të reja si dhe të kenë një garanci përdorimi jo më pak se 3 vjet nga marrja e tyre në dorezim" dhe te behet:

Produktet e furnizuara duhet të jenë të reja si dhe të kenë një garanci përdorimi sipas afateve te garancise te percaktuara ne specifikimet teknike, nga marrja e tyre në dorezim.

PIKA 5

Nje pjese e specifikimeve qe lidhen me pajisjet kompjuterike nuk jane sipas standarteve te miratuara nga AKSHI. Vendosja e ketyre specifikimeve krijon veshtiresi te shtuara per ne si OE per ti plotesuar, pasi prodhohen nga nje numer shume i kufizuar prodhuesish.

NE PERMBLEDHJE TE KESAJ PIKE;

Bazuar ne nenin 36 te LPP lutemi ndryshoni specifikimet e mesiperme, duke zbatuar standartet e

AKSHI-t per pajisjet elektronike”

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresat dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesat e plota të ankimuesve.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr.2059 prot., datë 04.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1674/1 prot., datë 07.07.2025 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, mbi ankesën e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të saj.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.2060 prot., datë 04.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1691/1 prot., datë 07.07.2025 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, mbi ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim të pjesshëm të saj duke praruar kërkesat si më poshtë:

“

- Për pikën 3 do të shtohet kriteri si më poshtë:

Shtohet

2.3.5 Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve (tti pàrkthyerà dhe noterizuarà) per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte modelet e produkteve qe do te ofrohen.

- Përgjigje ndaj hërkesës nr. 4:

Do të pranohet ankesa e operatorit ekonomik.

ISHTE

GARANCIA E PRODUKTEVE TE FURNIZUARA

Produktet e furnizuara duhet te jene te reja si dhe te kene një garanci perdorimi jo ml pak se 3 vjet nga marrja e tyre ne dorezim.

BEHET

GARANCIA E PRODUKTEVE TE FURNIZUARA

Produktet e furnizuara duhet të jenë të reja si dhe të kenë një garanci përdorimi jo më pak se afatet e përcaktuara në specifikimet teknike nga marrja e tyre në dorezim.

- Për Sistemin e Operimit “Preinstalled Licensed 0. S.”, OEM Ëindoës 10 64-bit Professional, OEM Ëindoës 10

ISHTE

NJESI QENDRORE PC TIP I

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
<i>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net</i>	<i>25000 Pike</i>
<i>“RAM”:</i>	<i>16 GB DDR4, min, 3200 MHz, Non-ECC</i>
<i>Madhësia e Hard Diskut “SSD Size”:</i>	<i>512 GB</i>
<i>“Disk Subsystem Controler”:</i>	<i>Serial ATA III 6 Gb/s</i>
<i>Karta Grafike “Graphics”:</i>	<i>Karte Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 4 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund te përdoret dhe adaptor)</i>
<i>“Media Device”:</i>	<i>DVD+/-R</i>
<i>“Slots”:</i>	<i>Min. (3) PCI/PCI-E, nga te cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16</i>
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
<i>Portat e Komunikimit “Ports”:</i>	<i>Min. (6) USB nga të cilat: a, Min, (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3,0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Porte DP/DVI/HDMI/VGA</i>
<i>“Networking”:</i>	<i>(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port</i>
<i>“Sound”:</i>	<i>Integrated Sound Card</i>
<i>“Speakers”:</i>	<i>Internal or Built-in Monitor</i>
<i>Siguria “Security Management”:</i>	<i>Embedded Security TPM 2,0</i>
<i>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:</i>	<i>OEM Windows 10 64-bit Professional</i>
<i>Tastiera “Keyboard”:</i>	<i>Standard Keyboard QWERTY</i>
<i>“Mouse”:</i>	<i>Minimum 3 Button Scroll Optical</i>
<i>Ushqimi “Power Supply”</i>	<i>220 V AC, 50 Hz,</i>

Kursimi i energjisë “Energy Efficiency”:	ENERGY STAR
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

BEHET

NJESI QENDRORE PC TIP 1

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
<i>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net</i>	25000 Pikë
“RAM”:	16 GB DDR4, min. 3200 MHz, Non-ECC
<i>Madhësia e Hard Diskut “SSD Size”:</i>	512 GB
“Disk Subsystem Controler”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 4 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor)
“Media Device”:	DVD+/-RË
“Slots”:	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3,0 x16
KOMUNIKIMI &	MENAXHIMI
<i>Portat e Komunikimit “Ports”:</i>	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
“Netëorking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Recover”:	Recover Partition
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
<i>Siguria “Security Ivtanagement”:</i>	Embedded Security TPM 2.0
<i>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed o.</i>	OEM Windows 11 64-bit Professional
<i>Tastiera “Keyboard”:</i>	Standard Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
<i>Ushqimi “Poër Supply”</i>	220 V AC, 50 Hz,
<i>Kursimi i energjise “Energy Efficiency”:</i>	ENERGY STAR
AKSESORET	
<i>Kabëll “Poër Cord”:</i>	Po, European
“Reco e	Recover Partition

GARANCIA	
<i>Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:</i>	<i>3 Vjet</i>

Për këto arsye kërkesa pranohet.

Sipas specifikimeve të AKSHI "Recover" është vendosur tek pjesa e aksesorëve dhe si rjedhojë është vendosur aty.

- Sistemi **Operativ: OEM** Ëindoës **10 64-bit Professional**

Kërkesa për OEM Ëindoës 10 do të merret parasysh duke e kthyer në OEM Ëindoës 11 64-bit Professional.

Për këto arsye kërkesa pranohet.”

II.6. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në datën 11.07.2025 pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar më shkresën nr. 1691/2 prot “*Formulari i Paraqitjes së Argumentave nga Operatori Ekonomik i Interesuar Optima Communication*”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, lidhur me vendimin e KSHA-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Optima Communication” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Nëpërmjet shkresës nr.2060 prot., datë 04.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1691/1 prot., datë 07.07.2025 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, mbi ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim të pjesshëm të saj duke praranuar kërkesat si më poshtë:

“

- Për pikën 3 do të shtohet kriteri si më poshtë:

Shtohet

2.3.5 Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve (tti pàrkthyerà dhe noterizuarà) per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte modelet e produkteve qe do te ofrohen.

- Përgjigje ndaj hërkesës nr. 4:

Do të pranohet ankesa e operatorit ekonomik.

ISHTE

GARANCIA E PRODUKTEVE TE FURNIZUARA

Produktet e furnizuara duhet tejene te reja si dhe te kene një garanci perdorimi jo ml pak se 3 vjet nga marrja e tyre ne dorezim.

BEHET

GARANCIA E PRODUKTEVE TE FURNIZUARA

Produktet e furnizuara duhet të jenë të reja si dhe të kenë një garanci përdorimi jo më pak se afatet e përcaktuara në specifikimet teknike nga marrja e tyre në dorezim.

- Për Sistemin e Operimit “**Preinstalled** Licensed 0. S.”, **OEM** Ëindoës 10 64-bit Professional, OEM Ëindoës 10

ISHTE

NJESI QENDRORE PC TIP 1

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
<i>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net</i>	25000 Pike
<i>“RAM”:</i>	16 GB DDR4, min, 3200 MHz, Non-ECC
<i>Madhësia e Hard Diskut “SSD Size”:</i>	512 GB
<i>“Disk Subsystem Controler”:</i>	Serial ATA III 6 Gb/s
<i>Karta Grafike “Graphics”:</i>	Karte Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 4 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund te pàrdoret dhe adaptor)
<i>“Media Device”:</i>	DVD+/-RË
<i>“Slots”:</i>	Min. (3) PCI/PCI-E, nga te cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI &	MENAXHIMI

Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (6) USB nga të cilat: a, Min, (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3,0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Porte DP/DVI/HDMI/VGA
“Networking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2,0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	Standard Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”	220 V AC, 50 Hz,

Kursimi i energjisë “Energy Efficiency”:	ENERGY STAR
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

BEHET

NJESI QENDRORE PC TIP 1

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net	25000 Pikë
“RAM”:	16 GB DDR4, min. 3200 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “SSD Size”:	512 GB
“Disk Subsystem Controller”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-Ex16, Min. 4 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor)
“Media Device”:	DVD+/-R

“Slots”:	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3,0 x16
KOMUNIKIMI &	MENAXHIMI
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
“Netëorking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Recover”:	Recover Partition
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Ivtanagement”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed o.	OEM Ëindoës 11 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	Standard Keyboard QËERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Poëer Supply”	220 V AC, 50 Hz,
Kursimi i energjise “Energy Efficiency”:	ENERGY STAR
AKSESORET	
Kabëll “Poëer Cord”:	Po, European

“Reco e	Recover Partition
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:	3 Vjet

Për këto arsye kërkesa pranohet.

Sipas specifikimeve të AKSHI "Recover" është vendosur tek pjesa e aksesorëve dhe si rjedhojë është vendosur aty.

- Sistemi **Operativ**: OEM Ëindoës **10 64-bit Professional**

Kërkesa për OEM Ëindoës 10 do të merret parasysh duke e kthyer në OEM Ëindoës 11 64-bit Professional.

Për këto arsye kërkesa pranohet.”

Referuar kësaj shkrese vërehet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e pjesëshëm të saj

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe*

vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5 Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i vendimit të autoritetit kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr.1691 prot., datë 27.06.2025, të operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK

III.2. Lidhur me pretendimine operatorit ekonomik ankimues “Optima Communication” SHPK mbi Kohëzgjatjen e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës: *për të cilin në DST është përcaktuar se Kohëzgjatja do të jetë 10 (dhjetë) ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës. Dhe ankimuesi kërkon modifikimin e këtij afati me pretendimin se Afati 10 ditor per levrim eshte jasht mase i shkurter per procedura te tilla, ne kete periudhe te vitit*”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr. 7 “*Formulari i Sasisë dhe grafikut të lëvrimit*”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas dokumentit ngarkuar në SPE: Lista e mallrave “Blerje Kompjuterash, Pajisje dhe Licenca”

Objekti: “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”

Afatet e lëvrimit: 10 (dhjetë) ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

KUSHTET PER TU ZBATUAR NE PRANIM.

Produktet e furnizuara duhet të jenë të reja si dhe të kenë një garanci përdorimi jo më pak se 3 vjet nga marrja e tyre në dorezim.

Shenim: Në rast të mos paraqitjes dhe mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta në fazën e furnizimit do të konsiderohen si kushte për refuzim të pranimit të mallit.

III.2.3. Në Listën bashkëlidhur DST sasia e mallrave që do të prokurohet është si më poshtë:

Blerje kompjuterash, pajisje dhe licenca					
Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi/njesi	Total
1	Njesi Qendrore Tip 1	Cope	10		
2	Monitor 27"	Cope	10		
3	Laptop Advanced	Cope	3		
4	Telefon Fiks Me Karte	Cope	1		
5	Tablet	Cope	10		
6	Radio Marrese Tip 1	Cope	24		
7	Radio Marrese Tip 2	Cope	11		
8	Platforme Menaxhimi MDM	Cope	1		
Total pa TVSH					
TVSH - 20%					
Total me TVSH					

III.2.4. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.5. Neni 3 Parime të përgjithshme *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III 2.6. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi*

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.2.7. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimuesit, si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit që lëvrimi i mallit do të bëhet “10 (njëzet) ditë nga data e lidhjes së kontratës”. Ky afat lëvrimi nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke

pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të mallit që do të lëvrohet. Ndaj KPP gjykon, se afati i lëvrimit të mallit në rastin konkret, duhet të jetë më i gjatë në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës, në mënyrë që ofertuesve t’ju lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallin me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objektankimi. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e afatit të lëvrimit të mallit në mënyrë të tillë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimes “Optima Communication” SHPK dhe “Blueprint Technologies” SHPK mbi *ndarjen në lote të procedurës së prokurimit objekt ankimi*”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7, “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, dhe Në Listën bashkëlidhur DST sasia e mallrave që do të prokurohet, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

Blerje kompjuterash, pajisje dhe licenca					
Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi/njesi	Total
1	Njesi Qendrore Tip 1	Cope	10		
2	Monitor 27"	Cope	10		
3	Laptop Advanced	Cope	3		
4	Telefon Fiks Me Karte	Cope	1		
5	Tablet	Cope	10		
6	Radio Marrese Tip 1	Cope	24		
7	Radio Marrese Tip 2	Cope	11		
8	Platforme Menaxhimi MDM	Cope	1		
Total pa TVSH					
TVSH - 20%					
Total me TVSH					

III.3.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit “162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuat, parashikon se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- d) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.3. Neni 39 i ligjit “162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se:

“Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet.

Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen.

3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.”

Në nenin 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorial

III.3.4. Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP konstaton, se objekti i këtij prokurimi është blerja nga ana e autoritetit kontraktor e pajisjeve kompjuterike të tilla si: Njësi qendrore Tip 1, Monitor Laptop dhe tablet, e pajisjeve ndërlidhje komunikimi si telefon dhe radiomarrëse dhe softëare Platforme Menaxhimi MDM. KPP vëren, se mallrat objekt - prokurimi kompjuter dhe laptop, të cilat janë pajisje elektronike të mirëfillta, nuk janë të së njëjtës natyrë me softëare Platforme Menaxhimi MDM dhe pajisjeve të ndërlidhjes dhe komunikimit, të cilat referuar edhe specifikimeve teknike të përcaktuara në shtojcën 6 të dokumentave të

tenderit, është e evidentueshme qartë që kanë të përfshirë brenda saj edhe elementë të natyrës së shërbimit nëpërmjet telefonit dhe ëebit, emailit si dhe në adresën e autoritetit kontraktor. Referuar parashtrimeve në ankesat rezulton, se ankimuesit kërkojnë ndarjen në lote të procedurës së prokurimit, pasi të treja llojet e produktit nuk ka asnjë karakteristikë të përbashkët me njëra tjetrën dhe prodhohen dhe tregtohen nga kompani krejtësisht të veçanata. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se ndarja ose jo, e një kontrate në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit, pasi ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, kostot e ekzekutimit të kontratës dhe vështirësia teknike lidhur me ndarjen në lote etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të paktë. KPP vlerëson, se mosndarja në lote e procedurës së prokurimit në rastin konkret, ul konkurrencën në radhët e operatorëve ekonomikë dhe nuk stimulon pjesëmarrjen e biznesit të vogël. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për ndarjen e procedurës në lote, në respekt të parimit të barazisë, të nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, si dhe nxitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimine operatorit ekonomik ankimues “Optima Communication” SHPK për modifikimin e specifikimeve *teknike të pajisjeve kompjuterike* për artikujt objekt prokurimi”, të parashtruara në formularin e ankesës të ankimit elektronik me A/2025/5486, datë 26.06.2025 dhe me nr. 1691/2025 prot, datë 27.06.2025, Komisioni i prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor për artikujt objekt prokurimi ka përcaktuar specifikimet teknike, si më poshtë:

Specifikime Teknike

Specifikimi i Materialeve:

NJESI QENDRORE PC TIP 1

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net	25000 Pikë
“RAM”:	16 GB DDR4, min. 3200 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “SSD Size”:	512 GB
“Disk Subsystem Controlder”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 4 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe

	adaptor)
“Media Device”:	DVD+/-R
“Slots”:	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
“Networking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”	220 V AC, 50 Hz,
Kursimi i energjisë “Energy Efficiency”:	ENERGY STAR
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

LAPTOP ADVANCED

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:	20000 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	16 GB, min. DDR4 2666 MHz
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	≥ 512 GB SSD
“Graphics”:	Dedicated Graphics ëith min. 4 GB Memory
“Media Device”:	DVD+/-R DL Internal ose External e të njëjtës Markë me Laptop-in;
	Memory Card Reader
Ekrani “Display”:	15.6" FHD LED (1920 x 1080), Anti-Glare
Bateria “Battery”:	Min. 60 Ëh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	

Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (3) USB 3.0/USB 3.1 (1) DP/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Ëeb Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Ëireless 802.11ac (Kompatabël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1;
“Sound”:	Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Ëindoës 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	QËERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Poëer Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:	3 Vjet

TABLET

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Processor Cores”:	Octa Core
“RAM”:	6 GB
Memorie e Brendëshme “Internal Memory”:	128 GB
“Removable Memory”:	Të Suportojë Kartë Memorje min. 128 GB
“Sensors”:	Fingerprint, Accelerometer, etj GPS- Internal
Ekrani “Display”:	≥ 8” FHD (1920 x 1200) multitouchscreen
Bateria “Battery”:	5000 mAh ose min. 4 Orë Punë
Kamera “Camera”:	Kamera para min. 5 Megapixel Kamera kryesore min. 13 Megapixel
Mbrojtja “Protection”:	Gorrilla Glass 5, IP68, rezistent nga rrezimi deri ne 1.8 metra
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	USB Tipi C ose ekuivalent

Rrjeti “Netëorking”:	3G Internet; 4G/LTE Ëireless 802.11ac (Kompatabël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V5.0;
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	Po
AKSESORËT	
Ushqyesi “Recharger”:	Po, European 220 V AC, 50 Hz
Flip Cover:	Po, Cover i pajisjur me teknologjine GDS ku te jete i perfshira konektori GDS dhe docking station perkates
Laps per tabletin	Po (jo detyrimisht i të njëjtës markë me tabletin)
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:	1 Vit

III.4.2. Në DST në sesionin 2 është përcaktuar shprehimisht:

2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (T.I.K.) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shqërisë së Informacionit:

Po ☐

Jo

X

2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (T.I.K.), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shqërisë së Informacionit:

Po ☐

Jo

X

III.4.3 Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” autoriteti kontraktor ka argumentuar se “*Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me paisjet elektronike duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

III.4.1. Neni 36 “*Specifikimet teknike*” i ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë

tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet, edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose të projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktorë të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshirë në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/i saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet

ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktorë në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktorë duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktorë duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktorë të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në

termat funksional sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*.

Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Ndërsa në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e

provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

III.4.3. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet t’i përmbahet stricto-sensu vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Komisioni i Prokurimit Publik duke marrë shkas nga argumentimi i autoritetit kontraktor për vendosjen e specifikimeve teknike për të cilat shprehet se është mbështetur në standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ndërkohë në DST ka përcaktuar që për specifikimet teknike të pajisjeve objekt prokurimi nuk është mbështetur në standartet e AKSHI dhe as nuk ka kërkuar miratim të specifikimeve nga ky institucion, dhe as të ndonjë organi tjetër ndërkombëtar, gjykon se ndodhemi përpara një kontradite përsa i përket specifikimeve teknike të hartuar. Vendimi nr. 673, Datë 22.11.2017 *“Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar në pikën 6/c të tij parashikon shprehimisht: “6.AKSHI, në ushtrim të veprimtarisë së saj, kryen edhe këto detyra e përgjegjësi të veçanta, si më poshtë vijon: c) Përcakton standardet shqiptare të TIK-ut, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, të cilat do të ndiqen nga administrata shtetërore. Këto standarde botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike”*. Në këto kushte Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor duhet të marri masa për hartimin e specifikimeve teknike për pajisjet kompjuterike objekt ankimi konform specifikimeve teknike të miratuara nga AKSHI për vitin 2025.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“Blueprint Technologies” SHPK heqjen e kërkeses për autorizim prodhuesi për artikujt me peshe shumë të vogël në*

totalin e procedures, artikujt nr.5 dhe nr.8 me argumentimi se kërkesa per autorizim prodhuesi per te gjithë produktet objekt prokurimi, perfshire ato qe zene nje peshe shume te vogel ne totalin e produkteve, nuk eshte ne perputhje me LPP (kerkese jo proporcionale)
Konkretisht, kërkesa per autorizim prodhuesi per artikullin nr.5 Tablet, qe perben me pak se 3% te totalit te fondit limit, nuk mbeshtetet ne LPP pasi nuk eshte kerkese proporcionale.
Gjithashtu kërkesa per autorizim prodhuesi per artikullin nr.8 Platforme Menaxhimi MDM, i cili eshte vetem 1 cope dhe perben me pak se 5% te fondit limit, nuk mbeshtetet ne LPP pasi nuk eshte kerkese proporcionale”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se:

III.5.1 Në shtojcën nr. 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në pikën 2.3.3 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon: 2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar për artikujt objekt në këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.*

III.5.2. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.5.3. Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë*

operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.5.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.5.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që “2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin*

e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar për artikujt objekt në këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.”. Referuar objektit të procedurës së prokurimit “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, si dhe nga verifikimi i shtojcës 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, Komisioni i Prokurimit Publik, në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar për të gjithë artikujt e kërkuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret nisur nga objekti prokurimit “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, si dhe referuar shtojcës 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, Komisioni gjykon se kërkesa për autorizim prodhuesi/distributori të autorizuar për artikujt tablet dhe Platforme Menaxhimi MDM është një kërkesë e ekzagjeruar, e cila ngushton konkurrencën. Sa më sipër autoriteti kontraktor të rishikojë kriterin e veçantë të kualifikimit, pikën 2.3.3 në mënyrë që të hapet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK heqjen e kërkesës për per ISO 27001 : 2022 ose ekuivalente për menaxhimin e sigurisë së informacionit me argumentin se nuk përputhet me objektin e kontratës”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.2 “Kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar si me poshtë. Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën e kërkuar për:

- **ISO 9001 : 2015 ose ekuivalente për menaxhimin e cilësive**
- **ISO 27001 : 2022 ose ekuivalente për menaxhimin e sigurisë së informacionit**

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të

punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.”

III.6.2. Në procesverbalin “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim”, të publikuar në SPE autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë vijon:

Argumentimi

- *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*
- *Duke qene se paisjet e kerkuara jane per sisteme sigurie si dhe teknologjia e kerkuar eshte e nje niveli te larte duhet qe subjektet zbatuese te kontrates te jene te pajisura me keto certifikime.*
- *Përmbushja e standartit **ISO 9001: 2015 ose ekuivalente** është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.*
- *Certifikimi **ISO 27001: 2022 ose ekuivalente** shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës duke siguruar që informacionet të menaxhohen në mënyrë të sigurtë duke qene se sistemi perpunon dhe administron informacione dhe te dhena te rëndësishme dhe sensitive . Ky certifikim garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet nderkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës.*

III.6.3. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) *të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) *të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) *të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.6.4. Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

II.6.5. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.6. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1.Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

III.6.7. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.6.8. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfitues direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat apo shërbimin që kërkon, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit, në mënyrë që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. Komisioni thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, të jenë të argumentuara dhe në funksion të objekti dhe qëllimit të procedurës së prokurimit në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Në varësi të objektit të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në LPP vendosja e kërkesave për kualifikim në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/ përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ai i dukshëm apo jo, të cilat kanë të njëjtin efekt.

III.6.9. Në lidhje me kriterin e autoritetit kontraktor për disponimin e certifikataës, objekt ankimi:

ISO 27001 : 2022 ose ekuivalente për menaxhimin e sigurisë së informacionit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse këto kërkesa shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Referuar objekti të prokurimit dhe specifikimeve teknike rezulton se autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë mallë. Referuar objektit të prokurimit: “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, në përmbushjen me sukses të kontratës dhe në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa e vendosur nga autoriteti kontraktor për disponimin e certifikatës ISO 27001 : 2022 ose ekuivalente për menaxhimin e sigurisë së informacionit, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe e pa argumentuar qartë nga autoriteti kontraktor, referuar dhe “Proces-verbalit mbi argumentimin e kriterëve për kualifikim” ku AK nuk është shprehur se përse janë të nevojshme dhe si ndikojnë këto certifikata për këtë procedurë prokurimi. Referuar dokumenteve të procedurës, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të kishte përcaktuar në mënyrë të qartë llojet e certifikatave më të nevojshme e që kanë lidhje direkt me objektin e prokurimit “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca” Komisioni gjykon, se pozita e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi do të rëndohej pa të drejtë, duke vendosur kriterë të fryra, në rastin konkret një certifikatë ISO e cilat nuk i shërben objektit të prokurimit dhe realizimit me sukses të kontratës. Referuar ankesës, operatori ekonomik me të drejtë kundërshton këtë kriter duke argumentuar se [...] nuk perputhet me objektin e kontratës. Kontrata në fjalë ka objekt blerje mallra ndërsa ISO i referohet sigurisë së informacionit (në procedurën në fjalë nuk ka shëmbim informacioni midis AK dhe OE)[...] Përsa më sipër

Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në këtë procedurë prokurimi nuk kërkon shërbime të specializuara apo procese komplekse të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit por janë blerje pajisje kompjuterike, ndërlidhje dhe liçenca. Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kriterin 2.3.2 si kriter jo në proporcion me natyrën e procedurës së prokurimit objekt-ankimi dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të garantuar zbatimin e kontratës, duke e modifikuar atë sipas konstatimeve mësipërme.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesë së operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - mall”, me nr. REF-51815-06-19-2025, me objekt “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe liçenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 01.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK. për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - mall”, me nr. REF-51815-06-19-2025, me objekt “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe liçenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 01.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK. për procedurën e mësipërme të prokurimit

4. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit dhe ta ndajë atë në lote dhe të kryejë modifikimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Optima communication” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

